



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __/__/2018

V E N D I M

Nr. 141, Datë 27.06.2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.89 Regj., datë 13.06.2018, të znj.L. H, kundër Bashkisë Shkodër dhe firmës “Miculi” sh.p.k. me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Subjekti ankues, znj.L. H shprehet se, me datë 09.09.2017 nga ana e firmës “Miculi”sh.p.k i janë prishur dy shtëpitë, përkatësisht njëra në emër të vet dhe tjetra në emër të nënës së saj, pa patur asnjë urdhër apo njoftim paraprak për prishjen e këtyre objekteve. Ajo citon se: “... shtëpitë në momentin e prishjes kanë qenë në proces legalizimi dhe urdhëri i skualifikimit ka ardhur me datë 06.10.2017. Bashkia Shkodër ka dhënë leje ndërtimi pa marrë më përpara urdhërin e skualifikimit nga ALUIZNI Shkodër. Po kështu dhe firma “Miculi” sh.p.k ka prishur objektin pa urdhërin përkatës dhe pa tagrin ligjor për ta bërë këtë”.

Lidhur me pretendimin për shkatërrim prone përmes prishjes së shtëpive sipërcituar, znj.L. H ka bërë një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Subjekti ankues pretendon se është diskriminuar nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Firmës “Miculi” sh.p.k pasi ata nuk kanë ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për prishjen e objekteve si për të gjithë qytetarët e tjerë dhe kërkon nga Komisioneri marrjen e sanksioneve për dy subjektet që kanë kryer diskriminimin.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ankuesja në rastin në fjalë ka paraqitur si shkak të diskriminimit të saj “gjendjen shoqërore”, dhe në shpjegim të këtij shkak citon se me gjendjen shoqërore ajo nënkupton padrejtësitë që i janë

bërë asaj lidhur me të drejtën për pronën, duke u ndjerë e pafuqishme përballë personave që gëzojnë pushtet.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk gëzon cilësitë e shkakut të pretenduar “*të gjendjes shoqërore*”¹, pasi “statusi social” mund të lidhet me pozitën e përfituar nga lindja në një komunitet ose klasë shoqërore të caktuar, si psh. përkatësia etnike, besimi fetar ose ideologjia; ose nga një situatë shoqërore si p.sh. varfëria ose të qenurit i pastrehë etj. Pikërisht përkatësia në një komunitet apo klasë të tillë shoqërore (apo dhe situatë specifike shoqërore si sipërcituar) do të përbënte vetë shkakun për të cilin mund të pretendohet diskriminimi, porë kjo në shpjegimin që i bën këtij shkak Komventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

¹ “Statusit social”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së znj.L. H, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime
Shkaku: Gjendje shoqërore